



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Nr. llog. Broj stranica Nr. pages	Nr. Prot. Bi Prot. Prot No. Data Datum Date
ANK-DPR 2	ON-2862/14 14.08.2014
PRISHTINË	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.08.2014, mori:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-711/14, për zyrtaret Sylejman Sylës - Shef i Inspektorëve të Ndërtimtarisë pranë Drejtorisë së Inspektimit në Komunën e Pejës, Pashkë Berishës dhe Bajram Muzlija –Inspektor në Drejtorinë e Inspektimeve të Komunës së Pejës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Në rastin e dyshuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-711/14, për zyrtarët e lartë: Sylejman Sylës-Shef i Inspektorëve të Ndërtimtarisë pranë Drejtorisë së Inspektimit në Komunën e Pejës, Pashkë Berishës dhe Bajram Muzlija –Inspektor në Drejtorinë e Inspektimeve të Komunës së Pejës.**

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se duhet më së pari të kontaktohet me palën e cila ka dërguar informatën pasi që informata e dërguar nëpërmes Postes është e pa qarte dhe duhen informata shtesë pasi që nuk e kemi pas të qarte situatën që pala ka dyshuar se ka Konflikt të Interesit.

Pasi jemi munduar të kontaktojmë nëpërmes telefoni por ka qenë e pamundur pasi që nuk është lajmëruar askush jemi detyruar që të shkojmë të kontaktojmë me palën në adresën e shënuar në informate.



Me datën 10.03.2014 kanë shkuar ne Komunën e Pejës dy zyrtarë të AKK-së, në adresën e palës qe e ka dërguar informatën, pra tek shtëpia e znj. Mykerrme Hoxha, Rruga Eliot Engel nr. 9 Pejë.

Në këtë adresë zyrtaret e AKK-së e kanë takuar një person i cili nuk ka dhënë informata, kur i kanë treguar se për qarë bëhet fjalë, ka filluar ti injoroj dhe te flas për punën e AKK-së, pastaj është prezantuar si djali i znj. Mykerreme Hoxhës, dhe ka thanë se ajo nuk është këtu dhe nuk merret me këtë punë, po pas insistimit te zyrtareve ju ka dhënë numrin e telefonit te personit qe është i autorizuar te flas për znj. Mykerreme.

Nga lokacioni ku kanë qen zyrtarët e AKK-së e kanë thirr në telefon por nuk është përgjigjur, ndërsa personit qe ka qenë i pranishëm i kanë lën porosi qe znj. Mykerreme, duhet te lajmërohet ne adresë te AKK-se sepse na duhen informata shtese për ta proceduar rastin me tutje qe është lajmëruar nga nena e tij .

Po ashtu prapë pas disa javësh është kontaktuar personi qe e kemi pasur numrin e tij dhe është përgjigjur se është djali i znj. Mykerreme Hoxha, avokati Blerim Hoxha, dhe është i autorizuar i saj për informatën e dërguar, gjatë bisedës kemi kërkuar nga ai qe te na e sqaron por është arsyetuar se nuk ka kohe te flas në telefon dhe se do vij në AKK-ë për informata shtesë.

Prapë edhe disa herë është thirr ne telefon po nuk ka pas qasje, ndërsa me datën 12.08.2014 është thirr dhe i është dërguar sms në telefonin e tij, pasi qe lënda duhej te mbyllej dhe pa informata te sakta nuk munde te nxjerrim konstatim te qarte edhe as kësaj here pala nuk është lajmëruar fare.

Vlerësojmë se në mungesë te informatave te sakta dhe te mjaftueshme dhe mos bashkëpunimit nga pala qe ka dërguar informatën nuk mund te vazhdojmë hetimin e mëtutjeshëm për parandalimin e konfliktit te Interesit për zyrtarët e lartë përmendur te Komunës se Pejës. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

